

Tregtia dhe Zhvillimi Ekonomik

Prof. Ahmet Mançellari dhe Dr. Selami Xhepa¹

ACIT/ WP/01(02)

Abstrakt

Dekada e viteve '90 shënoi fillimin e një gare konkurrionale drejt liberalizimit të regjimit tregtar në gati gjithë vendet e botës. Vendet që për dekada kishin përqaftuar politikat e zhvillimit nëpërmjet zëvendësimit të importeve ashtu si dhe ekonomitë e Europës Qendrore dhe Lindore zhvendosën kursin e politikave, duke u bërë pjesë e sistemit të tregtisë ndërkombëtare. Nga 50 vende që ishin anëtare të Marrëveshjes së Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë (GATT), sot është vështirë të gjesh vende që nuk janë anëtar apo në proces anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Arsyeja drejt kësaj lëvizjeje janë përfitimet që krijohen nga hapja e ekonomisë.

Shqipëria u bë pjesë e këtij sistemi që në fillimet e tranzicionit ekonomik, duke u institucionalizuar në sistemin botëror të tregtisë në vitin 2000, me anëtarësimin në OBT. Me inkurajimin nga Bashkimi Europian, vendi ynë është përfshirë në një proces të marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e rajonit, me synim që deri në fund të vitit 2006 të krijohet një zonë e tregtisë së lirë që të përfshijë gjithë vendet e Ballkanit Jugor (**Shih Aneks 1:** Vendet e përfshira në FTA dhe stadi i negociatave).

Qëllimi i këtij materiali është të nxisë debatin në mendimin e specializuar lidhur me rëndësinë dhe rolin e tregtisë së jashtme në Shqipëri në alokimin e burimeve dhe rritjen e efikasitetit ekonomik.

¹ Prof. Ahmet Mançellari është pedagog në Fakultetin e Ekonomisë së Universitetit të Tiranës dhe i atashuar pranë Qendrës Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT). Dr. Selami Xhepa është Menaxher i Kërkimeve pranë Qendrës Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT). Mendimet e pasqyruara në këtë material janë mendime personale të autorëve.

Tregtia dhe Zhvillimi Ekonomik


1. Tregtia dhe rritja ekonomike

Thellimi i ndërvarësisë ekonomike dhe forcimi i prirjeve globalizuese e ka bërë edhe më intensiv debatin mes studiuesve të ekonomisë për lidhjen midis hapjes tregtare, investimeve dhe rritjes ekonomike. Sidoqoftë, mbizotëron ideja se midis variablave të mësipërm ka një lidhje pozitive dhe se hapja ekonomike, liberalizimi i tregtisë shoqërohet në fund të fundit me ritme më të larta të rritjes ekonomike, me rritje të efikasitetit të përdorimit të faktorëve. Veçanërisht për vendet e vogla. Tregtia shndërohet në një faktor kyç rritjeje dhe zhvillimi veçanërisht për vendet në një stad modest zhvillimi apo që u nënshtrohen proceseve ristrukturoese e transformuese, sikurse janë vendet në tranzicion. Për këto të fundit, roli i tregtisë është kyç sidomos në rialokimin e burimeve, duke u shndërruar në një faktor bazë për rritjen e efikasitetit të përdorimit të tyre.

Çfarë ofron përvoja e ekonomisë shqiptare e 10 viteve të fundit lidhur me rolin e tregtisë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik?

Edhe një ballafaqim i thjeshtë grafik i ritmeve të rritjes së vëllimit të tregtisë dhe GDP, nxjerr në pah një lidhje pozitive midis tyre.

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
ne milionë dollarë									
Volumi tregtisë së jashtme	712.9	742.4	884.6	1157.6	790.3	1031.5	1217.4	1335.3	1642.1
Prodhimi brendshëm bruto	1228.1	1984.5	2422.1	2677.5	2294.5	3057.8	3676.4	3752.1	4113.7
Ritmi rritjes së tregtisë jashtme, %		4.1	19.2	30.9	-31.7	30.5	18.0	9.7	23.0
Ritmi rritjes së PBB real, %	9.6	8.3	13.3	9.1	-7	8	7.3	7.8	6.5




Megjithatë, në ç' masë mund të themi që tregtia ka ndikuar pozitivisht në ritmet relativisht të larta të rritjes ekonomike? Që tregtia ka ndikuar në një rialokim pozitiv të burimeve?

Që tregtia duhet konsideruar si një nga shtyllat e rritjes së efijencës së përdorimit të burimeve prodhuese në përgjithësi?

Le të qëndrojmë fillimisht te pyetja e parë. Dy momente që duhen vlerësuar.

Momenti i parë: drejtpërdrejt, tregtia shton në GDP vetëm vlerën e eksportit neto. Tabela 2 dhe grafiku 2 tregojnë se eksporti neto gjatë gjithë periudhës ka qenë negativ, në përmasa shumë të mëdha dhe, për më tepër, në rritje gjatë viteve të fundit. Pra, në këtë pamje të parë, as që mund të bëhet fjalë për ndikim pozitiv të tregtisë në rritjen ekonomike. Drejtpërdrejt, në një pamje statike, tregtia ka ndikuar negativisht në rritjen ekonomike. Duhet shtuar këtu edhe implikimet negative makroekonomike të defiçitit tregtar, të reflektuara në defiçitin buxhetor dhe, për rrjedhojë, në situatën e borxhit qeveritar².

<i>në milionë dollarë</i>	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Eksporte	111.7	141.4	204.8	243.7	158.6	208	274.4	255.9	304.6
Importe	-601.2	-601	-679.8	-922	-693.5	-811.7	-943.0	-1079.3	-1337.5
Defiçiti tregtar	-489.5	-459.6	-475	-678.3	-534.9	-603.7	-668.5	-823.4	-1032.9



Momenti i dytë: Raporti vëllim tregtar/GDP, pra shkalla e hapjes tregtare të vendit ka qenë mjaft modeste, edhe krahasuar me vendet fqinjë. Për vitin 2000, shkalla e hapjes tregtare për Shqipërinë ishte 59,3% për qind, duke qëndruar poshtë shkallës së hapjes së ekonomive të tjera të rajonit. Për vitin 2001 shkalla e hapjes tregtare u rrit në 63,6%.

² Rreth ¼ e vlerës së importeve mbulohet me të ardhurat valutore prej eksporteve, rreth ½ nga dërgesat valutore të emigrantëve; diferenca nga transfertat zyrtare. Këto të fundit pasqyrohen në bilancin fiscal të qeverisë, duke u pasqyruar edhe në situatën e borxhit të jashtëm.

Tabela 3: shkalla e hapjes së ekonomisë

Vendet	(X + M)/GDP*, në përqindje			
	1998	1999	2000	2001
Shqipëria	41.3	55.2	59.3	63.6
Bosnie Herzegovina	98.4	78.2	77.1	na
Bullgaria	97.7	99.6	122.1	na
Kroacia	88.8	89.2	95.8	na
Maqedonia	99.8	98	114.4	na
Rumania	56.1	62.6	73.7	na
FR Jugosllavia	66.4	56.0	81.2	na
SEE	72.5	74.8	86.9	na

(*Eksport import i mallrave dhe shërbimeve në raport me GDP: Burimi: Georgi Ranchev, 2001 "Free Trade Zone in Southeast Europe? The Harmonization of Tax and Customs Legislation" Research paper; për Shqipërinë treguesi është llogaritur sipas të dhënave të Bilancit të Pagesave, botim i Bankës së Shqipërisë, Gusht 2002)

Natyrisht, kjo pamje e parë nuk është shumë optimiste. Megjithatë, për një analizë më të plotë, është i nevojshëm një vështrim më i detajuar, më shumëplanësh, më dinamik. Një vështrim më nga afër i zhvillimeve të importit dhe të eksportit do të ndihmonte për këtë qëllim. Do të ndihmonte edhe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të tjera të parashtruara më sipër.

2. Tregtia dhe ndryshimet strukturore në ekonomi

• 2.a. Importet dhe struktura ekonomike

Sikurse tregojnë tabela 2 (dhe figura 2), vëllimi i importeve ka ardhur në rritje nga viti në vit, po kështu edhe pesha e importeve në PBB. Pesha e lartë e importeve në GDP krahasuar me peshën e eksporteve nxjerr drejtpërdrejt në pah një aspekt negativ e problematik të importit, që lidhet me defiçitin e lartë tregtar. Problematika e importit, megjithatë, nuk kufizohet vetëm me këtë aspekt. Ka një varg problemesh të tjera që lidhen me shkallën e lartë të informalitetit, të kontrabandës e korrupsionit, të dobësive institucionale e administrative, etj. Por, importi ka edhe një pamje tjetër, që nganjëherë neglizhohet por që mendojmë se meriton më shumë vëmendje, që mendojmë se meriton një vështrim më pozitiv, më pohues.

Së pari, importet kanë qenë një funksion pothuajse ekskluziv i biznesit privat, nja nga fushat e shfaqjes dhe rritjes së inisiativës së lirë private.

Së dyti, importet kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm, në periudha të caktuara (për shembull, 1997) edhe vendimtar, në plotësimin e nevojave të njerëzve.

Së treti, importet kanë ardhur përgjithësisht duke u rritur nga viti në vit, por, për disa produkte, mbulimi i konsumit me prodhimin vendas ka ardhur gjithashtu duke u rritur. Kërkesa e lartë për mallra importi ka shërbyer si sinjal pozitiv për prodhimin vendas. Është shënuar kështu një lloj zëvendësimi i importeve me prodhimin vendas në sektorë përkatës.

Së katërtri, importet, megjithë ndikimin e drejtpërdrejtë negativ në rritjen ekonomike, kanë pasur edhe një ndikim pozitiv në prirjet rristrukturoese të ekonomisë.

Analiza e dinamikës strukturore të importit e nxjerr më qartë në pah këtë aspekt të fundit pozitiv të tij. Nga tabela 4 vëmë re se peshën më të ndjeshme në strukturën e importeve shqiptare gjatë gjithë periudhës 1995-2001 vazhdojnë ta ruajnë importet e makinerive dhe pajisjeve, në intervalin 16–18 për qind të totalit, me tendenca rritëse veçanërisht gjatë viteve të fundit. Grupi i dytë me peshë më të madhe në importe janë tekstilet, në masën 9-11 për qind të totalit të importeve; luhatshmëria e kësaj peshe reflekton zhvillimet në sektorin e rieksporëve. Rritje të ndjeshme ka pësuar gjithashtu edhe importi i energjisë dhe karburanteve, (për shkak sidomos³ të krizës energjitike gjatë dy viteve të fundit) duke arritur në 13.8 për qind të totalit të importeve, nga vetëm 5 për qind në vitin 1996.

Tabela 4: Struktura e importeve

IMPORTI SIPAS GRUPEVE						
në %						
Pershkrimi	1996	1997	1998	1999	2000	2001
Kafshët e gjalla; Produkte me origjinë kafshore	5.0	4.3	5.2	4.4	2.8	2.2
Produkte vegjetale	17.5	13.2	10.1	9.1	8.4	7.6
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	2.9	3.2	3.3	1.9	2.0	1.5
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	9.5	7.3	8.9	11.5	9.0	8.1
Produkte minerale	5.2	7.6	8.5	8.6	13.1	13.8
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	4.8	5.9	7.5	5.4	5.6	5.4
Plastika; goma dhe artikuj të tyre	2.3	3.1	3.0	2.8	3.0	2.8
Lëkura, artikuj të tyre	2.1	2.2	2.3	2.2	1.8	2.1
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	0.8	1.2	1.2	1.7	1.0	0.9
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	1.4	1.3	1.6	1.5	1.6	1.5
Tekstile dhe artikuj tekstile	9.0	10.4	12.9	12.5	11.9	10.4
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	6.3	5.7	4.9	3.7	2.6	3.5
Art. prej guri, allcie, cimentoje; qeramike; qelq	2.4	3.5	3.5	3.2	3.9	3.7
Perla; bizhuteri; monedha	0.1	0.0	0.0	0.1	0.2	0.0
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	4.8	6.6	6.7	8.0	7.8	8.8
Makineri e pajisje mekanike, elektrike	16.2	15.8	9.8	11.6	13.8	18.4
Mjete transporti	6.1	4.9	6.7	7.5	7.4	5.3
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	1.3	1.2	1.1	1.4	1.7	1.5
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	2.1	2.3	2.6	2.5	2.4	2.4
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikat	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.0
TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

³ Edhe masat në funksion të reduktimit të evazionit fiskal në organet doganore (si masat administrative, ashtu edhe reduktimet e tarifave doganore), kanë ndikimet e tyre në ndryshimet strukturore të vëzhguara, por që janë të pamundura të kuantifikohen.

Importi i makinerive dhe pajisjeve ka kontribuar në rritjen e stokut të kapitaleve fikse dhe në rinovimin e bazës teknoke të ekonomisë. Tabela 5 jep informacion mbi shpërndarjen e makinerive dhe pajisjeve⁴ të importuara sipas sektorëve të ekonomisë.

Tabela 5: Struktura e importeve të makineri e pajisjeve sipas sektorëve, në %

	1995	1996	1998	1999	2000	2001	totali
makineri e pajisje bujqesore	3.6	4.4	2.5	2.9	2.0	1.8	2.5
agroindustria	10.5	11.3	4.4	4.3	1.9	6.7	5.9
makineri e pajisje ndertimi	23.3	38.8	34.7	45.6	48.1	17.2	33.4
industria mekanike	10.7	3.3	4.2	3.3	8.0	4.6	5.3
Industria mobilje-furnitura	5.3	3.6	2.9	2.1	2.2	2.5	2.7
industria e letres dhe shtypshkrimit	3.2	4.0	4.8	3.4	2.1	1.3	2.6
industria tekstile	11.6	7.7	23.9	12.7	8.0	5.8	9.7
lekure kepuce	3.4	4.1	4.4	4.1	2.0	2.5	3.1
ICT	28.4	22.8	18.2	21.8	25.6	57.7	34.8
Total:	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

(Burimi: llogaritur sipas të dhënave të Data Base të ACIT).

Nga tabela vërehet se sektori më atraktiv i makinerive dhe pajisjeve të importuara, pra dhe sektori që i është nënshtruar më shumë rinovimit teknologjik, ka qenë ai i i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (ICT). Për vitin 2001 afro 58 për qind e makinerive dhe pajisjeve të importuara u drejtuan në këtë sektor, duke e kaluar më se dy herë nivelin e vitit 2000. Për periudhën 1995-2001 mesatarisht rreth 35 për qind e totalit të importeve të makineri e pajisjeve janë drejtuar në këtë industri. Në vend të dytë qëndron industria e ndërtimit, me 33 për qind të totalit. Më pas rreshtohen industria e tekstileve dhe këpucëve me 12.8 për qind, sektori i bujqësisë dhe i industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale me 8.4 për qind së bashku, etj.

Një pjesë të ndjeshme në strukturën e importeve kanë pasur lëndët e para për industrinë e vendit, veçanërisht për sektorin e eksporteve (importet e tekstileve dhe artikujve të tyre – me rreth 10 për qind të totalit të importeve).

Nga një krahasim qoftë dhe jo shumë i detajuar i tablosë strukturore të importit me strukturën e ekonomisë së vendit në tërësi, mund të arrijmë në përfundime që gjithsesi tërheqin vëmendjen për një qëndrim më pohues ndaj importit dhe rolit të tij.

Së pari, vërehet një korrelacion i fortë pozitiv midis ndryshimeve strukturore në zërin makineri e pajisje dhe ndryshimeve strukturore në ekonomi. Për shembull,

- Rritja e importeve të ICT pasqyrohet në rritjen e peshës së shërbimeve;
- Rritja me ritme mjaft të larta e sektorit të ndërtimit reflekton edhe rritjen e importit të makinerive dhe pajisjeve, por edhe një pjese të materialeve që përdoren në këtë sektor;
- Rritja e industrisë tekstile dhe asaj të përpunimit të lëkurës, që përbën edhe një ndër shtyllat e eksportit, reflekton edhe rritjen e makinerive dhe

⁴ Riklasifikimi i importeve të makineri e pajisjeve sipas sektorëve është bazuar në sistemin e harmonizuar (HS) tarifor, kryesisht në nivelin 4 shifror, në dijen tonë më të mirë për përkatësinë e grupeve të caktuara të mallrave në korrespondencë të një sektori. Ky riklasifikim mbulon mesatarisht 54 për qind të totalit të kodit XVI të sistemit tarifor (totalit të makineri e pajisje mekanike, elektrike dhe mjeteve të transportit).

pajisjeve si dhe lëndëve të para të importuara, që përdoren në këto industri.

- Ose, ritmet relativisht të ulëta dhe në ulje të bujqësisë, produktiviteti i ulët në këtë sektor, ndër të tjera pasqyrojnë edhe peshën e vogël dhe në rënie të importeve të mekanikës bujqësore.

Së dyti, nëpërmjet kontributit në rritjen e stokut të kapitalit dhe në rinovimin teknologjik të sektorëve përkatës, importi kontribuon në “kufizimin e vetvetes”. Pra, në kushtet e ekonomisë sonë, që po i nështrihet një procesi të rëndësishëm ristrukturimi, “zëvendësimi” i importit, në një farë kuptimi, mund të realizohet vetëm nëpërmjet “mbështetjes” së tij. “Mbështetja” në këtë rast nënkupton ndërmarrjen e politikave që inkurajojnë importin sidomos të makinerive e pajisjeve, sidomos të makinerive e pajisjeve që përfaqësojnë teknologji të përparuar dhe që drejtohen në sektorët me kërkesë të lartë tregu⁵.

Së treti, importi i lëndëve të para për t’u përpunuar në vend për nevoja të tregut të brendshëm apo të tregjeve të huaja shoqërohet gjithashtu me efekte pozitive si nga pikëpamja e shtimit të vlerës, ashtu edhe nga pikëpamja e punësimit, etj.

Së katërti, struktura e importeve dhe veçanërisht dinamika e saj shërbejnë si një burim sinjalesh për prodhuesit vendas, për identifikimin e hapësirat investuese. Kështu ka ndodhur jo vetëm me mjaft produkte bujqësore, por edhe me produkte të industrisë agro-përpunuese, të industrisë së veshjeve, të mobiljeve, etj.

2.b Eksportet: probleme dhe prirje

Eksportet nuk janë qëllim në vetvete. Një funksion kryesor i eksporteve, por jo i vetëm, është sigurimi i burimeve valutore për financimin e importeve të mallrave dhe shërbimeve. Një funksion tjetër i rëndësishëm është mundësia që jep eksporti, i konsideruar tashmë si proces, me të gjitha hallkat që e bëjnë atë të mundur, për ristrukturimin e ekonomisë, për orientimin e burimeve prodhuese në përdorime më eficiente, për rritjen e aftësisë konkurruese të ekonomisë.

Tiparet specifike të ekonomisë sonë, si ekonomi e vogël dhe në tranzicion i japin më shumë rëndësi këtij funksioni të dytë të eksportit. Eksporti i “rrit” përmasat e ekonomisë duke krijuar hapësira për ekonomizime të shkallës. Përfshirja gjerësisht në procesin e eksportit, nga ana tjetër, “krijon” mundësi për një proces efektiv dhe eficient rialokimi burimesh, duke ndihmuar edhe për ripajisjen teknologjike të ekonomisë.

Si i ka realizuar eksporti në rastin e Shqipërisë këto dy funksione të tij?

Le të qëndrojmë fillimisht te funksioni i parë, ai i sigurimit të burimeve valutore për financimin e importit. Pamja që hapet këtu nuk është aspak optimiste. Në vitin 2001 vetëm 23 për qind e importeve u financuan me të ardhurat valutore nga eksportet. Rolin kryesor në mbushjen e këtij hendeku kaq të madh e kanë luajtur dërgesat e migrantëve

⁵ Nevoja për inkurajim të importit të makinerive dhe pajisjeve nuk zbeh aspak nevojën për nxitjen e investimeve të huaja.

(që arrijnë të mbulojnë rreth gjysmën e defiçitit tregtar), të plotësuara nga financimet prej institucioneve ndërkombëtare dhe transfertave të tjera të zyrtare. Tabloja bëhet edhe më shqetësuese po t'u referohemi prirjeve ngushtuese që pritet të shfaqin jo vetëm financimet e huaja, por edhe dërgesat e emigrantëve.

Sfida paraqitet serioze. Si mund të përballohet ajo? Si mund të ngushtohet defiçiti tregtar? Kjo është një pyetje e vështirë, përderisa edhe situata është e vështirë. Ajo do të mbetet një pyetje e hapur për sa kohë që defiçiti tregtar do të jetë një problem serioz. Së fundi, pyetja është tepër komplekse për të guxuar të japësh një përgjigje “përmbyllëse”. Në këtë situatë, ajo çka do të përpiqemi të bëjmë ne në këtë prezantim është para së gjithash ta zbërthejmë këtë pyetje në disa prej komponentëve që i konsiderojmë të rëndësishëm, duke synuar thjesht në hapjen e debatit dhe këmbimin e mendimeve të pjesëmarrësve në diskutim, për të arritur në qëndrime që së bashku do t'i konsideronim të dobishme për t'u mbajtur parasysh si në procesin e hartimit të politikave përkatëse qeveritare, ashtu edhe në procesin e vendimmarrjes së biznesit të përfshirë në aktivitetin tregtar.

Pra, t'i rikthehemi pyetjes: Si mund të ngushtohet defiçiti tregtar?

1. **Duke kufizuar importet?** Përmasat shumë të mëdha të importit krahasuar me eksportin duket sikur e përlligjin një qëndrim të tillë. Megjithatë, një analizë më e vëmendshme tregon se mundësitë e kufizimit të importit janë mjaft “të kufizuara”. Pse? Mendojmë se ka disa faktorë që veprojnë në këtë drejtim.

Së pari, fillimi i tranzicionit u shoqërua me një hapje shpërthyesë të vendit ndaj botës perëndimore. U shumëfishuan kontaktet e njerëzve, veçanërisht për shkak të emigracionit, me mënyrën perëndimore të jetesës. Nevojat pësuan një rritje shpërthyesë. Të ardhurat nga emigracioni apo të ardhura të tjera kanë kushtëzuar një kërkesë të qëndrueshme, në nivele relativisht të larta për mallra importi. A mund, me politika kufizuese, të kufizohet kjo kërkesë? Veçanërisht për mallra që dalin jashtë rrethit të mallrave të domosdoshëm? Kemi mendimin se do të ishte një sipërmarrje e vështirë, që të mos themi e pamundur. Aq më tepër kur është fjala për mallra të ashtuquajtura “luksi”, kërkesa për të cilat është elastike lidhur me të ardhurat.

Së dyti, në fillimet e tranzicionit, për një periudhë kohe, vendi ishte pothuajse tërësisht i varur nga ndihmat e huaja ushqimore dhe importi. Aparati prodhues u paralizua pothuajse tërësisht. Më tej, në fillim bujqësia e mandej edhe degët e tjera të ekonomisë filluan të rimarrin veten. Prodhimi vendas filloi, gradualisht të “zëvendësonte” importin (natyrisht, edhe ndihmat ekonomike). Megjithatë, ky proces “zëvendësimi” nuk u shoqërua me pakësimin e vëllimit të importit, përkundrazi, ai ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Krahas me rritjen e prodhimit vendas, pa folur në për efektet pozitive në rritjen e nevojave, filloi të rritej edhe pesha e mallrave kapital në importe. Pra, po ndodh një lloj “zëvendësimi i importeve” përmes “rritjes” së tyre.

Sidoqoftë, ekzistojnë mjaft hapësira për nxitjen e procesit të zëvendësimit të importeve. Mendojmë se politikat mbështetëse të këtij procesi duhet të orientohen më mirë drejt krijimit të një klime më të përshtatshme investimesh, duke përkrahur veçanërisht sipërmarrjen e re dhe biznesin e vogël e të mesëm, duke nxitur më mirë

importimin e makinerive e pajisjeve e mallrave të tjera kapital, duke inkurajuar veçanërisht importimin e teknologjisë së përparuar, duke nxitur investimet e huaja direkte në ekonomi. Me efekt do të ishin edhe politika të orientuara në përmirësimin e infrastrukturës së tregut, në mbështetjen e aftësisimit menaxherial të biznesit, etj. Gjithashtu, mund të mendohet edhe për hapësira politikash për nxitjen e financimit të investimeve me anë të dërgesave të emigrantëve apo, përgjithësisht për nxitjen e rritjes së normës së kursimeve. Për shembull, nëpërmjet përpjekjeve për formalizimin e kanaleve të dërgimit të parave? Pa mohuar efektet pozitive të një përpjekjeje të tillë, efektet e pritura në investime mendojmë se nuk do të ishin të konsiderueshme. Mjafton të mbajmë parasysh raportin shumë të ulët kredi tregtare-depozita për sistemin bankar. Gjithsesi, rritja e shkallës së kursimeve dhe orientimi i tyre drejt investimeve duhet vënë në raport me gjithë proceset reformuese e ristrukturuese. Nuk mjaftojnë politika specifike.

Së treti, shkalla e ulët e hapjes ekonomike të vendit nuk flet në dobi të thirrjeve për kufizimin e importit. Edhe sikur të mendonim për momentin një rritje të eksportit në nivelin e importit, përsëri shkalla e hapjes e Shqipërisë do të ishte më e ulët se ajo e vendeve të rajonit. Pra, zgjidhja nuk mund të kërkohet thjesht në kufizimin e importit, qoftë edhe nëpërmjet “zëvendësimit” të tij.

2. **Duke nxitur eksportet?** Jo vetëm shembja e aparatit prodhues të ekonomisë, por edhe e lidhjeve të jashtme ekonomike me fillimin e tranzicionit, u reflektuan në paralizimin pothuajse tërësor të eksporteve. Mandej, gradualisht filloi riaktivizimi i burimeve prodhuese dhe PBB filloi ngritjen e tij, me ritme relativisht të larta. Edhe eksporti filloi një farë mëkëmbjeje. Për një periudhë, ritmet ishin mjaft të larta, duke kaluar ato të GDP, mandej edhe ritmet e importit.. Për gjithë periudhën 1993-2001, eksportet u rritën mesatarisht me 16 për qind në vit, ndërsa importet me 12 për qind. Megjithatë, kjo dukuri nuk është dhe aq ngushëlluese, kur ballafaqojmë nivelet absolute të eksportit, me ato të importit dhe të PBB. Për më tepër, gjatë viteve të fundit është vërejtur një farë rënie edhe e ritmeve të rritjes së eksporteve.

Jo vetëm kaq. Problematika e eksporteve paraqitet mjaft më e pasur. *Së pari*, eksportet, gjatë gjithë periudhës janë karakterizuar nga një shkallë shumë e ulët diversifikimi. Për shembull, për vitin 2001, nga rreth 5000 produkte të përfshira në klasifikimin 6 shifror të Sistemit të Harmonizuar (HS), vetëm 30 prej tyre përfaqësonin 83.5 për qind të totalit të eksporteve të vendit. Një shkallë e tillë e ulët diversifikimi i bën eksportet shumë të ndjeshme ndaj ndryshimit të konjunkturave tregtare. *Së dyti*, eksportet janë karakterizuar gjithashtu nga një nivel i ulët i vlerës së shtuar të produkteve që hyjnë në përbërje të tij. Ri-eksporti që konsiston në veshje dhe këpucë (64% e totalit të eksportit në vitin 2001), karakterizohet nga një numër i kufizuar operacionesh përpunimi dhe vlera e shtuar lokale tek këto produkte konsiston pothuajse vetëm në vlerën e punës. Por edhe pjesa tjetër e produkteve të eksportit vuan përgjithësisht nga e njëjta dukuri, veçanërisht produktet bujqësore, minerale, etj.

Pra, situata e eksporteve nuk le vend për entuziazëm. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se përpjekjet për nxitjen e eksporteve do të ishin të pafrytshme dhe zgjidhja e problemit të defiçitit tregtar e pashpresë. Problematika që paraqet eksporti thjesht dëshmon se nxitja e tij nuk është një synim që realizohet lehtë. Por, megjithatë, nxitja e eksporteve, rritja e tyre mbetet alternativa bazë e zgjidhjes së problemit të defiçitit tregtar, përderisa mundësitë për të operuar me anën e importeve janë mjaft të kufizuara. Jo vetëm kaq. Duke nxitur eksportet, kontribuohet edhe në zgjidhjen e detyrës madhore të tranzicionit: ristrukturimit të ekonomisë. Midis ristrukturimit të ekonomisë dhe nxitjes së eksporteve duket sa ka një korrelacion të fortë pozitiv. Rritja e eksportit dhe përmirësimi strukturor i tij do të jenë edhe matësit më të mirë të shkallës së ristrukturimit të ekonomisë, të shkallës së aftësisë konkurruese të saj. Këtej dalin dy përfundime të rëndësishme. **Së pari**, realizimi i synimit të nxitjes së eksporteve kërkon mbështetjen para së gjithash në politika që kanë si objekt thellimin e proceseve reformuese e ristrukturoese. Në këtë kuadër rëndësi të veçantë marrin reformat institucionale. **Së dyti**, politikat specifike të orientuara ndaj nxitjes së eksporteve mund të jenë të sukseshme vetëm në masën që mbajnë parasysh dhe mbështeten në aktivizimin e instrumenteve të tregut, në masën që këto instrumente janë krijuar dhe veprojnë.

Çfarë politikash specifike do të ishin të efektshme për nxitjen e eksporteve? Natyrisht, kjo është një pyetje e hapur dhe shpresojmë që seminari i sotëm të kontribuojë në shtrimin e një platforme diskutimi e vlerësimi të politikave të mundshme, alternative. Mendojmë se, në çdo rast, politikat alternative specifike do të duhej të mbanin parasysh, veç sa thamë më sipër, edhe (1) nevojën e biznesit për **informacion** konkret, specifik, veçanërisht lidhur me tregjet potenciale; (2) nevojën e *lidhjeve konkrete*, “institucionale” të prodhuesve në këto tregje; (3) nevojën për nxitjen e lidhjeve të biznesit vendas, të orientuar nga eksporti, me biznese të huaja dhe, përgjithësisht, për nxitjen e investimeve të huaja direkte; (4) orientimin për mbulimin e segmenteve “relativisht të pambuluara” të tregut, siç është nxitja e eksporteve me produkte jashtë stine, etj.; (5) nevojën për mbështetje lidhur me aftësimin menaxherial, financimin, infrastrukturën përkatëse, lehtësitë institucionale, etj.

E dobishme, mendojmë, do të ishte edhe një analizë e kujdesshme e dinamikës së eksporteve gjatë periudhës pas viteve '90. Tabela 6 jep informacion mbi avantazhet e shfaqura krahasuese për produktet që u takojnë dy prej grupeve kryesore të eksportit, produkteve bujqësore dhe atyre të industrisë ushqimore.

Tabela 6: Avantazhet e shfaqura krahasuese për kategorinë e mallrave bujqësore dhe industrisë ushqimore

HS	ZERI	1996	1997	1998	1999	2000	2001
1	Kafshet e gjalla	-0.9	-0.8	-1.0	-1.0	-0.9	-0.8
2	Mishi	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
3	Peshku	0.3	0.1	0.0	-0.1	-0.5	-0.5
4	Produktet bulmetore	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-0.9	-0.9
5	Produktet me origjinë kafshore	0.7	0.1	0.5	0.4	-0.9	-0.6
6	Pemet dhe bimët e tjera të gjalla	0.3	0.3	-0.5	-0.8	0.1	-0.9
7	Zarzatet e ngrënëshme	-0.6	-0.5	-0.6	-0.7	-0.7	-0.8
8	Frutat, arrat dhe lekurat e agrumeve	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
9	Kafe, çaj dhe erezë	-0.6	-0.2	0.4	-0.6	-0.9	-0.9
10	Drithërat	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
11	Produktet e industrisë bluajtëse; malti, niseshte	-1.0	-1.0	-1.0	-0.9	-1.0	-1.0
12	Farat vajore dhe frutat me përmb. vajore	0.8	0.9	0.8	0.7	0.7	0.9
13	Gomat, rreshirat dhe lëngje dhe ekstrakte vegjetale	0.3	0.6	-0.5	0.5	0.7	0.6
14	Materiale vegjetale që përdoren për thurje	1.0	-1.0	-0.9	-1.0	-1.0	-1.0
15	Vajra dhe dhjamera kafshore apo vegjetale	-0.7	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
16	Ushqimet e përgatitura prej mishit, peshkut	-0.9	0.0	-0.2	0.0	0.3	0.4
17	Sheqernat dhe embelsirat prej tij	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
18	Kakao dhe përgatitjet prej saj	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
19	Përgatitjet prej drithrave miell, niseshte qumesht	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0	-1.0
20	Përgatitjet prej zarzavateve, frutave, arrave	-0.9	-1.0	-1.0	-0.9	-0.8	-0.8
21	Përgatitje të ndryshme të ngrënëshme	-1.0	-0.7	-0.9	-0.9	-0.9	-0.9
22	Pijet, alkolet dhe uthullat	-1.0	-1.0	-0.9	-0.9	-0.9	-0.9
23	Mbetjet dhe kthimet nga ind. ushqimore	-1.0	-0.8	-0.9	-1.0	-1.0	-0.7
24	Duhani dhe zevendesuesit e përpunuar të tij	0.0	0.6	0.2	-0.5	-0.5	-0.6

Sikurse vërehet nga tabela, indeksi i avantazheve të shfaqura krahasuese⁶ për shumicën e produkteve dhe pothuajse për të gjithë periudhën e marrë në shqyrtim, është negativ. Megjithatë, një vështrim më i vëmendshëm mund të identifikojë edhe disa prirje pozitive, megjithëse ende të dobëta. Për shembull, në klasat 12 dhe 13, janë ruajtur avantazhet e shfaqura krahasuese në tregjet e huaja, ndërsa duke filluar nga viti 2000, avantazhe po fitohen në grupmallin e produkteve ushqimore. Detajimi i këtij informacioni deri në nivele produktesh të veçanta, do të ishte një informacion i dobishëm jo vetëm për arsye të studimeve akademike, por dhe me vlerë praktike për sipërmarrjen private që synon të hyjë në tregjet e huaja.

⁶ Indeksi llogaritet si raport i shumatorës së diferencës eksport-import për çdo grup malli me shumatorën e shumës së eksport-importit të tyre. Vlerat negative tregojnë për mungesë të avantazheve të shfaqura krahasuese ndërsa vlerat pozitive për ekzistencë të avantazheve. Për më tepër, i parë në dinamikë, vlerat e indeksit ofrojnë evidenca të performancave: nëse një mall apo grupmalli po fiton apo po humbet avantazhet krahasuese në tregjet e huaja. Megjithatë, theksojmë se llogaritjet e këtij indeksi duhet të detajohen deri në nivel produktesh të veçanta për një pamje më të plotë. Gjithashtu, vlera e këtij indeksi nuk është limituese, veçanërisht për vende si Shqipëria, ku volumet e eksporteve janë shumë të vogla. Kjo do të thotë se avantazhe mund të ekzistojnë në mjaft produkte të tjera, të cilat aktualisht nuk tregtohen në tregje të huaja por vetëm në tregjet e brendshëm.

Si përfundim, duke mbajtur parasysh të dy funksionet e eksportit të parashtruara më sipër, mund të themi se strategjia e zhvillimit ekonomik të vendit, e në këtë kuadër edhe e ngushtimit të defiçitit tregtar, duhet të mbështet para së gjithash në nxitjen e eksporteve. Politikat e zëvendësimit të importeve pa dyshim që janë të rëndësishme, por, ato mund të jenë edhe sukseshme dhe në kohezion me synimet ristrukturuese të ekonomisë, vetëm në qoftë se se i nënshtrohen vizionit strategjik të nxitjes së eksporteve.